REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 923prot. Ballsh, më 29.02.2024

VENDIM

Nr. 14, datë 29.02.2024

"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 12, DATË 24.02.2020, TË KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR""

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar , ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjit nr.44, datë 30.04.2015 " Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Mallakastër, të miratuar me VKB-në nr.12, datë 24.02.2020, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 32 ndryshohet, si më poshtë vijon:

Neni 32
Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm

Këshilli i Bashkisë ka **9 (nëntë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

1. Komisioni i Mandateve, 4 anëtare/ë
2. Komisioni i Ekonomisë, 5 anëtare/ë
3. Komisioni Juridik, 5 anëtare/ë
4. Komisioni i Urbanistikës, Shërbimeve dhe Zhvillimit të Teritorrit, 5 anëtare/ë
5. Komisioni i Bujqësisë, 5 anëtare/ë
6. Komisioni i Arsimit, 5 anëtare/ë
7. Komisioni i Emergjenncave, 5 anëtare/ë
8. Komisioni i Barazisë Gjinore, 5 anëtarë/e
9.Komisioni i Integrimit Evropian, 5 anëtare/ë.

1. Komisioni i integrimit evropian të përbëhet nga pesë (5) këshilltarë, tre nga shumica dhe dy nga pakica, dhe të ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak kur votojnë "Pro" shumica e Këshilltarëve. Në përcaktimin e përbërjes së Komisionit respektohen kërkesat e barazisë

gjinore.Propozimet për anëtarët e Komisionit bëhen nga kryetarët e Grupeve të Këshilltarëve të cilët ia paraqesin Kryetarit të Këshillit.

Komisionit i integrimit evropian do të jetë përgjegjës dhe ka të drejtë :

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga proçesi i anëtarsimit në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efiçencë të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë,nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të përformancës së bashkive në procesin e integrimit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integrimit Europian, organizon në Bashki, në bashkepunim me strukturat e qeverisë qëndrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi më të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërrmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Nexhmi Sulaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTER